



---

## Asociacioni i Komunave të Kosovës

### R A P O R T

nga

**Takimi i Kolegjiut për Zyrtarë për Integritime Evropiane**

**Prishtinë, 4 maj 2011**

---

**Për:** Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

**Nga:** Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

**Lënda:** Raport nga takimi i Kolegjiut për Zyrtarë për Integritime Evropiane



## HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për zyrtarë të integritimeve evropiane organizoi takimin e radhës së këtij Kolegjiut me 04 maj 2011 (e mërkurë) me fillim nga ora 11:00 në ndërtesën e re të Komunës së Prishtinës në Dragodan.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

- Analiza e PVPE-së
- Rekomandime për matricën e PVPE-së për komuna

Në këtë takim morën pjesë zyrtarë për integritime evropiane të Komunave të Kosovës, përfaqësues nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Ministria e Integritimeve Evropiane, përfaqësues të AKK-së, si dhe përfaqësues të projektit të binjakëzimit të BE-së. Takimi u kryesua nga Kryesuesi i Kolegjiut për zyrtarë të integritimeve evropiane, z. Shaqir Mala.

z. Shaqir Mala, Kryesues i Kolegjiut për zyrtar të Integritimeve Evropiane – në fjalën hyrëse falënderoj AKK-në për organizimin e këtij takimi dhe po ashtu falënderoj të gjithë për pjesëmarrje në këtë takim, sidomos zyrtarët nga Ministria e Integritimeve Evropiane dhe Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal . Në vazhdim z. Mala i dha fjalën z. Pleurat Sejdiu drejtor për integritime evropiane në MIE.

z. Pleurat Sejdiu – në fjalën e tij falënderoj organizatorët dhe shtoj se takimet e tilla janë të dobishme për avancimin e agjendës evropiane drejt një suksesi të përbashkët. Analiza e raportit të progresit nxjerr rekomandimet dhe sfidat për veprim ndër to edhe një analizë për komunat. Raporti i progresit si pikë referimi do të përputhet me procesin e përpilimit të buxhetit sipas planit të punës së 2011 të Qeverisë së Kosovës. Për të parën herë në PVPE mbi 95% të veprimeve janë buxhetuar, nga 1.2 miliard Euro, mungojnë më pak se 281 milion për të mbuluar të gjithë PVPE-në, dhe për këtë kemi premtime se do të kontribuojnë donatorët për të mbuluar këtë zbrazëti.

Sipas PVPE ka 400 veprime – 60 prej tyre janë politike- 60 prej tyre ekonomike dhe 280 standarde evropiane. Mbikëqyrja do të bëhet në baza tre mujore për rishikim të zbatimit të veprimeve, dhe raportet do të jenë 6 mujore dhe vjetore. Kemi marrë komentet e të gjitha palëve si dhe KE-së; janë futur indikatorët dhe tani do të jetë më lehtë të maten rezultatet dhe ecuria e procesit. Po ashtu do të kemi edhe vizita nga KE i cili do të verifikojë përmbushjen e obligimeve.

Ertan Munoglu, Menaxher i Programit në AKK – në vazhdim të diskutimit sqaroi se pas vizitave në komuna së bashku me Kryesinë e kemi përgatitë planin e punës për Kolegjiutin e zyrtarëve për integritime evropiane për vitin 2011. Sa i përket analizës së PVPE-së, znj. Aisling prezent në takim është ngarkuar nga KE për të rishikuar dhe thjeshtëzuar pjesën e Komunave të PVPE-së. Ajo të bëjë një prezantim të kësaj analize dhe rekomandimeve të saja, dhe pastaj do të mund të diskutojmë dhe parashatrojmë pyetje lidhur me këtë.

znj. Aisling Lyon- në prezantimin e analizës dhe rekomandimeve të saja cekti se ky dokument është vetëm një draft, dhe do të diskutojmë për çdo pikë të punës. Lë të sqarojmë në këtë dokument pikat e

padobishme të cilat i shihni si të tepërta dhe nëse keni për të shtuar ndonjë rekomandim tjetër të nevojshëm për këtë plan.

Duhet të bëjë një sqarim për dokumentin – këtu janë paraqitur dy tabela të ndara por që janë të ndërlidhura ngushtë me njëra-tjetrën: i) relacionet mes Grupit Punues për Dialogun e Procesit të Stabilizim-Asociimit, Grupeve Punuese për Integrim Evropian dhe Plani i Veprimit për Partneritet Evropian, dhe ii) Linjat Raportuese për Zyrarët për Integrim Evropian. Është me një rëndësi të veçantë roli juaj, bashkëpunimi, komunikimi si dhe raportimi për punën tuaj tek Kryetarët. Duhet të them se nuk kam krijuar aktivitete pa arsye ku do të ketë një referencë për punën si dhe angazhimin dhe përgjegjësinë e çdo drejtori për të kryer punën përkatëse si dhe raportimi i tyre ndaj jush.

Pleurat Sejdiu - ky është një dokument shumë i mirë për punën e zyrarëve për integrim evropian, duhet të kemi të qartë se gjatë zbatimit të detyrave dhe punës tuaj, drejtoritë komunale duhet të informohen për rëndësinë e integrimeve evropiane, mënyrën e bashkëpunimit dhe vlerësimit të punës për PVPE. Duhet të ketë një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha njësitë drejt një suksesi të përbashkët.

Arben Salihu - MEI - PVPE është një plan strategjik, prej 1200 veprimesh ku kemi shkurtuar atë në 400 veprime që të jetë sa më e lehtë në zbatimin e tyre. Plani të jetë si mostër që të hartohet në të ardhmen nga komunat apo MAPL për sektorë dhe fusha të ndryshme se cilat do të jenë përgjegjësitë dhe aktivitetet e punës të komunave si dhe raportimi i tyre. Në përgjithësi ky është një plan i mirë për punë tuaj.

z. Shaqir Mala, Kryesues i Kolegjiut - vërejtjet dhe përfundimet tona do të përcillen me kohë, sepse ky është një dokument shumë i mirë nga zonja dhe ne si Kolegjiut do ti propozojmë MAPL-së ta pranojë si matricë, dhe të bëhet sa më shpejt nxjerrja e saj.

Rexhep Bllaca, zyrtar ligjor në MIE – theksoj se MIE është dukë përgatitë rregulloren për zyre për integrim evropian në komuna. Në grupin punues është një përfaqësues nga zyrarët për integrim evropian, z. Mala andaj edhe do të ju informojë për punën tonë. Drafti fillestar iu është dërguar juve për rekomandime, sepse është një rregullore që tenton të themeloj zyra për Integrim Evropian në të gjitha komunat dhe do të specifikojë punët për nivelin komunal. Drafti final do të jetë gati deri javën e fundit në qershorit kur edhe pritet të aprovohet, andaj ju lus deri atëherë të dërgoni sugjerimet tuaja për këtë rregullore.

z. Shaqir Mala, Kryesues i Kolegjiut - informoj se projekt rregullorja do të duhet të precizojë punën dhe përgjegjësinë për punën e zyrarëve të Integrimeve evropianë në komuna andaj adresoni shqetësimet tuaja për punën e rregullores, por duhet të themi se është një projekt shumë i mirë dhe i kapshëm për të gjithë. Duhet të figurojë qartë roli i zyrarëve për Integrim Evropian, ku duhet të profilizohet puna dhe zyra dhe jo të ketë një punë dytësore.

Pleurat Sejdiu - është me rëndësi se me këtë rregullore do të profilizohet zyra dhe puna e juaj, raportimi i të tjerëve për punën ndaj jush, si dhe mbledhjen e informatave të ndryshme të nevojshme për këtë dokument.

Ertan Munoglu, Menaxher i Programit në AKK – do të ishte mirë të diskutojmë se cilat janë problemet që ballafaqohen komunat dhe zyrtarët rreth matricës dhe të dalim me rekomandime për MAPL-në.

z. Azem Osmani, zyrtar për informim në Komunën e Podujevës - kërkoj një informim se a ka paraparë Qeveria dënime për mos realizimin e atyre standardeve apo obligimeve të cilat kanë komunat dhe se si do të veprohet për ato komuna të cilat nuk i realizojnë detyrat përgjegjëse. Po ashtu a do të ndihmojë në financime të projekteve për ato komuna të cilat kanë realizuar me sukses detyrat e tyre.

z. Shaqir Mala, Kryesues i Kolegjiutit - sqaroj se do të jenë ministritë e linjës të cilat kanë për detyrë dhe janë përgjegjëse për ndëshkimet apo shpërblimet në përmbushjen e detyrave të përcaktuara sipas rregullores .

znj. Nexhmije Kallaba, zyrtare për integrime në Komunën e Kamenicës- në fjalën e saj përmendi rëndësinë e PVPE në nivel komunal. Ka një paqartësi rreth funksionalizimit të zyrave në komuna, dilemë ende mbetet funksionalizimi i zyrave dukë marrë parasysh numrin e vogël të zyrtarëve i cili zakonisht është i vetëm në kryerjen e punëve. Cila do të jetë pjesa e komunave në buxhetin e parapri për PVPE, si të do të shfrytëzohen këto mjete nga ana e komunave dhe sa do të shpërblehen komunat në përmbushjen e standardeve për integrime evropiane.

Fatmir Berisha, zyrtar për integrime në Komunën e Gjakovës - u shpreh se nuk është e thënë që komunat të cilat nuk do të plotësojnë kriteret do të ndëshkohen apo nuk do të financohen për punën e tyre sepse ne kemi punën dhe përgjegjësinë kryesorë në mbledhjen e informatave të cilat i marrim dhe raportojmë për përmbushjen e tyre.

z. Shaqir Mala, Kryesues i Kolegjiutit – rikujtoj të pranishmit se është puna e jonë e përbashkët në përmbushjen e standardeve rreth procesit të integrimit në BE. Do të duhet të kemi edhe një diskutim me zyrtarët qeveritar rreth buxhetit dhe përfitimit të komunave në këtë proces. Duhet tu bëj me dije se nga takimi që kam pasur me zyrtarët ligjor të Kryeministritë dhe Ministrive të linjës kemi marrë përkrahjen maksimale për fuqizimin e rolit të zyrtarëve për integrime evropiane, vetëm do të bëhet edhe një rishikim i bazës juridike nëse nuk bie ndesh me ligjet në fuqi. Komunat do të kenë rolin e tyre në përmbushjen e standardeve evropiane, dhe do të më vinte shumë keq nëse kjo rregullore nuk do të respektohet nga Kryetarët e komunave.

Ajshe Bërveniku, zyrtare për integrime evropiane në Komunën e Prishtinës - propozoj se në pikat e diskutimit për takimin e radhës të jetë edhe koordinimi rreth projekteve me agjensionet për zhvillim rajonal si dhe bashkëpunimi rreth punëve për investime të IPA-s së.

Rekomandimet:

1. Dokumenti i propozuar nga znj. Lyon do t'i dërgohet të gjithëve për komente dhe sugjerime.